



## 1. Hyrje

### Justifikimi i kërkimit

Mbrojtja e bimëve në bujqësi është ndër praktikat më të rëndësishme agronomike. Kjo është e tillë për dy arsye të mëdha; sëmundjet dhe insektet bëjnë një dëm të madh ekonomik, dhe se produktet për mbrojtjen e bimëve ndaj tyre në shumicë janë jo miqësore me shëndetin e njerzëve, gjallesave të tjera dhe mjedisin në përgjithësi. Zhvillimi i bujqësisë është shoqëruar me përpjekjet e vazhdueshme për të përdorur produkte gjithnjë e më miqësore. Edhe industria prodhuese e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB-ve), gjithnjë e më tepër po orientohet në prodhimin e insekticideve dhe fungicideve sa më tolerant me mjedisin. Edhe puna universitare i edukon specialistët e ardhshëm të mbrojtjes së bimëve me konceptet e mbrojtjes së integruar dhe biologjike, pikërisht për të nxitur përdorimin e produkteve me ndikime sa më minimale në mjedis. Puna shkencore ka ndikuar dhe ndikon çdo ditë në dhënien e fakteve mbi efektin negativ të produkteve kimike të forta dhe po nxjerr dobinë ekonomike dhe ekologjike të produkteve me ndikime të pakta ose minimale në shëndet dhe mjedis. Cilësia e lartë e produkteve bujqësore nuk mund të kuptohet pa cilësinë e lartë të inputeve. Kjo është një prirje pozitive mbarë botërore, pavarësisht nga shpejtësia e ecjes në këtë rrugë.

Edhe ky studim ka për synim pikërisht të testojë disa produkte miqësore me mjedisin që do të përdoren në mbrojtjen e ullirit nga miza (*Bractocera olea*).

**2. Qëllimi i kërkimit:** Prodhimi i ullirit dhe vajit me cilësi të lartë, nëpërmjet saktësisht të momentit të ndërhyrjeve kimike për mbrojtjen nga miza e ullirit me metoda të reja inovative.

**Vendi i studimit: Shamogjin - Vlorë:** Kultivari: Ogliarola, Nociara, Coratina, Cima di melfi, Frantoio, Lecino. Koha: Korrik - Nëntor, 2017. Zbatues: Mendim Baçaj - Agronom i Mbrojtjes së Bimëve, Llambro Dhima - Specialist Pentarie

### 3. Miza e ullirit (*Bractocera olea*), dëmtuesi kryesor i frutave të ullirit.

Kudo në botë miza e ullirit (*Bractocera olea*), vlerësohet si dëmtuesi kryesor i prodhimit të ullirit. Dëmin e shkakton larva, pikërisht mbi kokrrat. Dëmi i shkakton nga larvat e mizës është dëm sasiore, sepse larva konsumon tulin e kokrrës, por edhe dëm cilësor sepse kokrrat e plagosura ose bien në tokë, ose vaji i tyre ka aciditet të lartë, sepse në kokrrat e ullirit zhvillohen kërpudhat saprofike të kalbëzimit të tulin të kokrrës.

#### 3.1 Përshkrimi i stadeve të mizës së ullirit

- **Insekti i rritur**, i mizës ka madhësi 4-5 mm.

- **Veza**: Ka formë cilindrike të zgjatur dhe me ngjyrë të bardhë e më vonë në të verdhë krem. Femra i vendos vezët me vezëlëshuesin e saj në tulin e kokrrës deri në 3 mm thellësi.

- **Larva**. Ka ngjyrë të bardhë në krem dhe me gjatësi nga 2 - 8 mm sipas moshës së saj.

Larva e mizës dëmton sasinë e prodhimit dhe cilësinë e tij.

- **Pupa**. Pas kalimit të moshave larva kthehet në pupë si tek të gjitha mizat e tjera. Pupa ka ngjyrë krem e më vonë kafe. Ka formën e një fuçie me unaza tërthore.

Miza e ullirit dimëron në stadin e pupës. Në muajt Maj-Qershor nga pupat dalin insektet e rritur. Popullata e mizës në përgjithësi gjatë verës është e ulët, rritet gjatë muajit Shtator me intensitet sidomos pas shirave të parë të Shtatorit, ajo rritet me shpejtësi duke arritur maksimumin gjatë muajit Tetor dhe sidomos deri në fund të muajit Nëntor.

### 3.2 Dëmi

Miza ullirit është dëmtuesi numër një i frutave të ullirit si në Shqipëri ashtu edhe në të gjithë vendet mesdhetare ku rritet mbi 90% e ullishtarisë botërore.

Miza, shkakton dëm sepse ushqehet me tulin e kokrrave të ullirit. Ajo pakëson peshën e kokrrave, shkakton rrëzimin e tyre duke pakësuar sasinë e prodhimit. Frutat e plagosura nga ngrënia e frutave bëhët shkak për infeksionet nga kërpudhat saprofite. Këto kërpudha shkaktojnë kalbëzimin e kokrrave. Proçesi i kalbëzimit të tulin të kokrrës bëhët shkak për rritjen e nivelit të aciditetit të vajit. Dëmi i shkaktuar nga miza lëviz sipas kultivarëve dhe kohës së vjeljes së tyre nga 10% deri në 50 % të prodhimit dhe të cilësisë së vajit.

### 3.3 Mënyra jetesës

Miza, si të gjithë përfaqësuesit e klasës Diptera (Dykrashëshit), ka një zhvillim me metamorfozë të plotë, domethënë që stadet ndryshojnë, pra pësojnë metamorfozë nga një stad tek tjetri. Miza gjatë jetës së saj kalon në këto faza: **Miza, veza, larva, pupa**. Nga pupa del miza e cila vazhdon ciklin. Nga stadi në stad, pra nga miza në mizë plotësohet një brezni ose siç thuhet ndryshe gjeneratë.



Miza femër duke vendosur vezën në kokrrën e ullirit



Veza në tulin e kokrrës



Pupa në tulin e kokrrës




Larva në tulin e kokrrës



Pupat

**Figurë 1.** Cikli biologjik i mizës së ullirit (*Bractocera olea*)



Figurë 2. Mënyra e jetesës së mizës së ullirit

Miza, dimëron si pupë në thellësi 2-3 cm thellë. Mizat nga pupat dalin me shumicë pas muajit Maj, dhe akoma më dinamike është shfaqja e tyre në muajin Qershor kur frutat e ullirit fillojnë e rriten. Mizat femra lëshojnë vezët në tulin e kokrrës 1.3 mm në thellësi të frutit. Një mizë femër lëshon mesatarisht 200 vezë për brezni. Nga lëshimi i vezës deri sa çel larva, kalon mesatarisht një javë. Zhvillimi larvës deri sa ajo kalon tre moshat rritje kalojnë mesatarisht 15 ditë. Një cikël zhvillimi i një breznie zgjat 23 deri 30 ditë. Brezitet më të shkurtra zhvillohen gjatë muajit Gusht dhe muajit Shtator. Miza e ulliri zhvillon 4-6 breznie në vit. Brezitet e muajit Tetor dhe muajit Nëntor shkakton shumë dëm. Kur muaji Nëntor është i ngrohtë popullata është e fuqishme dhe mund të infektojë 100% të frutave. Muaji Korrik dhe muaji Gusht është periudha më e qetë për mizën. Pas shiut të parë të muajit Shtator popullata dhe infeksioni rritet me shpejtësi. Ullishtet në kushte të ujtitëshme edhe muaji Gusht mund të shoqërohet me infeksione në fruta. Gjithashtu kjo lidhet edhe nga kultivarët. Kultivarët për konsum për kokërr, infeksioni fillon qysh në muajin Gusht, kjo sepse tulli i kokrrës në këto kultivarë ka thellësi dhe lëng të mjaftueshëm për zhvillimin e saj. Në ullishtet e ujitura në verë kushtet për zhvillimin e larvës në kokërr janë favorizuese.

#### **4. Mbrojtja e ullirit nga miza (*Bractocera olea*).**

Mbrojtja e ullirit nga miza realizohet duke zbatuar disa strategji. Strategjitë mbrojtëse varen nga sistemi i bujqësisë që zbatohet në ullishtarët në ullishtet e tyre.

Sistemet kryesore bujqësore që zhvillohen në ullishte janë: sistemi **konvencional**, sistemi i **integruar** dhe sistemi **biologjik**, ose ekologjik/organik i prodhimit të ullirit dhe vajit.

Sistemi konvencional përdor produkte të mbrojtjes së bimëve dhe plehra konvencionalë, në ullishtarinë e integruar përdoren produkte më tolerante për shëndetin dhe mjedisin, ullishtaria biologjike/organike/ekologjike, përdor produkte miqësore me shëndetin dhe mjedisin. Studimi në zbatim meqënëse ka si objektiv prodhimin me cilësi shëndetësore dhe mjedisore ka përdorur pikërisht produktet e mbrojtjes së bimëve shumë tolerante ndaj shëndetit, gjallesave dhe mjedisit në përgjithësi. Prodhimi i ullirit i dalë pas përdorimit të tyre nuk ka fare mbetje kimike të dëmshme.


Studimi ka pasur si objektiv të dytë, që këto produkte miqësore me mjedisin të përdoren për mbrojtjen nga miza të kultivarëve të ullirit vendas. Kjo është vendosur kështu për t'i dhënë mundësin tregut në radhë të parë, kultivarëve të ullirit vendas, sepse dihet që ato janë më të preferuar për konsumatorin vendas dhe për eksportin.

## 5. Materiali dhe metoda

**Tabelë 1.** Mënyra të përdorimit të produkteve, për mbrojtjen nga miza (*B.olea*) e Ullirit.

| <b>Produktet e mbrojtjes së bimëve të përdorura kundra mizës (<i>B.olea</i>), përshkrimi tyre dhe metodat e përdorimit</b> |                                                                                                                               |                                                           |                                                                                                                                  |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Produktet</b>                                                                                                           | <b>Lënda vepruese</b>                                                                                                         | <b>Doza përdorimit</b>                                    | <b>Metoda përdorimit</b>                                                                                                         |
| DAP (Diamon Fosfat)                                                                                                        | Pleh fosforit, Diamon Fosfat                                                                                                  | 50 gr në futur në një shishe me ujë 1,5 litërshe          | Varen shishet me tretësirë DAP dhe ujë në një pemë por, dhe një pemë jo ose edhe për çdo pemë                                    |
| Success 024                                                                                                                | Spinosad dhe proteina plus sheqerna (regjsztraur për ullishtarinë biologjike)                                                 | 300 gr për dynym duke shpenzuar 300 ml tretësirë për bimë | Përdoret çdo 20 ditë por, edhe sipas fluturimit të mizës. Trajtohet një pjesë e kurorës dhe një pemë ulliri po dhe një jo.       |
| Eko-Trape                                                                                                                  | Grackë feromoni seksual tërheqës për mizën e ullirit, kripë amoni dhe kartona me mbetjet e insekticidit Decis (Deltamethrinë) | 100- 150 copë për ha në varësi të dendësisë së ullishtes  | Një pemë me qeska dhe një pemë pa qeska ekotrapit. Ose kur bimët janë shumë të mëdha qeskat e feromonit varen edhe bimë për bimë |
| Kaolinë                                                                                                                    | Pluhur i dheut argjilor Kaolinë                                                                                               | 4 kg kaolinë në 100 litra ujë                             | Spërkatet kurora e ullirit duke e mbuluar atë me një shtresë të hollë tretësire, si të jetë mbuluar kurora nga pluhuri i rrugës  |
| Bio Botan                                                                                                                  | Vaj nga bima e Nimës (Neem)Vaj nga bima Neem, spec djegës dhe hudhra                                                          | 2 kg vaj Nime (Neem) në 100 litra ujë                     | Spërkatet e gjithë kurora                                                                                                        |
| Kontroll                                                                                                                   | Pa trajtime me produkte                                                                                                       | -----                                                     | -----                                                                                                                            |

Produktet përdoren për vrasjen, kapjen ose largimin e insekteve të rritur të mizës së ullirit (*B.olea*), ndërsa Bio Botan ka efekt edhe mbi larvat.



## Bio BOTAN

**PËRBËRËSIT:**  
Azadiraktinë 20%, Urtika 15%, Tenacetum 20%, Artemisia 15%, Vaj vegjetal 30%.  
Meqenëse përbërësit bazë janë më bazë bimore, pra botanike si bima e Nimës etj, eprodukti quhet BioBotan.

**FUSHA PËRDORIMIT:**  
Insekticid (insektet e fluturave, mizave, zhuzhakëve, këpushave breshkëzave, krahebardhës së serrave, afideve), Nematocid, Antibiotik Natyral me veti si fungicid për disa raste.

**MËNYRA VEPRIMIT:**  
Nëpërmjet kontaktit direkt, ka veprim nervor dhe largues. Krijon anomalitë në zhvillimin e fazave të insekteve, duke i denaturuar dhe deformuar ato. Insektet femra në kontakt me produktin kufizojnë vezëdhënien ose e ndërpresin atë. Larvat dalin me defekte morfologjike. Zotëron edhe antibiotikë, duke dhënë edhe efekte anti-kërpudhore. Shërben edhe si plehërues gjethor ose thithet edhe nga rrënjët e bimëve.

**DOZA PËRDORIMIT:**  
Përdoret 2000 mililitra ( 2 Litra) produkt BioBotan në 100 Litra ujë.

**VEPRIMI MBI INSEKTET E DOBISHËM DHE MJEDISIN:**  
Nuk e dëmtan blatën, dhe insektet e dobishme në bujqësi.

**KËSHILLA PËR PËRDORIMIN:**  
Të mbahet larg fëmijëve dhe të ruhet në mjedise të freskëta dhe të ajrosura.

**AFATI SKADIMIT:** 2 vjet pas hapjes së produktit.

**AFATI PRITJES:** Spërkatje - Konsum i produkteve të trajtuara-1-2 ditë

Rekomandohet të përdoret edhe në bujqësinë biologjike.

Prodhuar nga "R.G.M. BIO — ALBANIA" shpk  
Koha prodhimit: Gushit, 2015  
Ambalazhuar nga kjo kompani me bidona 5 Litereshe

**Figurë 3.** Pamje nga paketimet,etiketat e produkteve të përdorura në provat fushore për mbrojtjen e ullirit nga miza (*B.olea*), 2015.



**Tabelë 2.** Skema e vendosjes të studimit BEP Shamogjin-Vlorë.

Jugu

Lindja

| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|----|
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |
| X | X | X | X | X | X | X | X | X | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  | X  |

Veriu

- Legjenda:** Rrjeshti 5 - Olike, kultivari Ogliarola  
 “ 7 - Kaolina, kultivari Niciara  
 “ 14 - Bio Botan, kultivari Coratina  
 “ 17 - Success 024, kultivari Cima di melfi

## 6. Metodrat e monitorimit të mizave të rritura

Ecuria e fluturimit të insekteve të rritur të mizave të ullirit është realizuar me grackat e feromoneve tërheqëse të tipit Mackfail. Grackat janë kontrolluar një herë në 7ditë. Kur bëhet kontrolli parë, hiqen mizat e rëna në gracka që të mos të numërohen përsëri në kontrollin e dytë.

Kur kemi disa gracka numri i mizave shënohet për çdo grackë dhe llogoritet sa miza janë kapur mesatarisht për çdo grackë. Kemi bërë kujdes që gjatë numërimit të mizave në grackën e feromonit të mos ngatërrojmë mizën e ullirit me mizën e Qershisë (*Regoletis cerasi*) dhe me mizën mesdhetare (*Ceratitis capitata*).

Të dhënat për mizat e kapura në gracka hidhen në tabelën e mëposhtme. Kur kapen 4-6 miza për çdo grackë për javë është një sinjal për përdorimin e metodave për vrasjen e mizave të rritura. (si me Success 024, Eko-trape, Gracka me DAP etj.).




**Figurë 4.** Pamje gjatë numërimit të mizës së Ullirit (*B.olea*), në grackë.




**Figurë 5.** Aspekte nga trajtimet kimike - BEP Shamogjin.

### Flutrimi i mizës së Ullirit (*B.olea*)




### Infeksioni aktiv KM Berati




**Grafikë 1; 2.** Dinamika e fluturimit të mizës së ullirit (*B.olea*) dhe rezultatet grafike të infeksionit në kokërr në kultivarin KM Berati.





### Fluturimi i mizës së ullirit (*B.olea*)



### Kultivari Kalinjot



**Grafikë 3; 4.** Dinamika e fluturimit të së ullirit (*B.olea*) dhe grafiku i infeksionit aktiv në kokërr në kultivarin “Kalinjt” Sarandë.



**Grafikë 5; 6; 7; 8.** Fluturimi i mizës së ullirit (*B.olea*) në bazën Shamogjin-Vlorë me kurthe të tipit Mackfail.

### 7. Analizat në frutat e ullirit për infeksionin nga miza (*B.oleae*).

Për të marrë vendime të drejta dhe në kohën e duhur duhet të dimë fazat e mizës, raportin mes tyre. Analizat fillojnë në momentin kur bërthama e ullirit fillon të forcohet deri tre javë para vjeljes. Një analizë përfundimtare bëhet në kohën e vjeljes jo për qëllim të luftohet miza e ullirit, por për të vlerësuar infeksionin përfundimtarë kur ulliri shkon në fabrikë, ose ulliri i tavolinës shkon për konservim.

Kokrrat për analizë meren në në kurorën e ullirit në lartësinë e trupit të njeriut. Për çdo rrënjë mund të meren 10 ose 20 kokrra. Në një bllok ulliri prej 1 ha meren 100 kokrra ulliri të mara në 10 pemë ulliri. Marja e mostrave bëhet në mënyrë krijuese, kjo në varësi të madhësisë së bllokut, terrenit të ullishtes, kultivarit të ullirit etj,. Sa më shumë kokrra të ketë mostra e ullirit për analizë, aq më e saktë pasqyrohet gjendja e infeksionit të frutave.

**Tabelë 3.** Regjistrimi i shkallës së infeksionit të frutave të ullirit nga larvat.

| Kokrra të analizuarra 100 |                                            |      |               |                  |      |              |             | Ifeksioni total real |
|---------------------------|--------------------------------------------|------|---------------|------------------|------|--------------|-------------|----------------------|
| Shembull                  | Shpime sterile nga miza femër por, pa vezë | Vezë | Larva të reja | Larva të rritura | Pupa | Galeri boshe | Këllëf pupe |                      |





**Tabelë 4.** Infeksioni aktiv në kokërr i shprehur në %.

| Nr. | Data e analizës | Success 024 | Olive | Kaolina | Bio Botan | Eco trap | Kontrolli |
|-----|-----------------|-------------|-------|---------|-----------|----------|-----------|
| 1.  | 11.09.2017      | 0           | 0     | 0       | 1         | 1        | 2         |
| 2.  | 17.09.2017      | 1           | 1     | 2       | 1         | 1        | 3         |


|    |            |   |   |   |   |   |   |
|----|------------|---|---|---|---|---|---|
| 3. | 24.09.2017 | 2 | 1 | 2 | 2 | 2 | 4 |
| 4. | 01.10.2017 | 3 | 3 | 3 | 3 | 4 | 5 |
| 5. | 08.10.2017 | 4 | 3 | 3 | 3 | 4 | 4 |
| 6. | 15.10.2017 | 3 | 4 | 4 | 4 | 3 | 5 |
| 7. | 22.10.2017 | 3 | 4 | 5 | 5 | 4 | 5 |
| 8. | 30.10.2017 | 4 | 5 | 5 | 6 | 5 | 6 |



**Figurë 6.** Monitorim në bimë për infeksionin nga miza e ullirit (*B.olea*).







**Grafikë 9; 10; 11; 12; 13; 14.** Siç shihet nga paraqitja grafike infeksioni nga miza e ullirit (*B.olea*), është shumë i ulët duke mos përbërë asnjë shqetësim për prodhimin e ullirit.

**Tabelë 5.** Analizat e vajit të ullirit.



| MOSTRAT    | Data e vjeljes | Kultivari     | Varianti    | Aciditeti % | r. Peroks. (mEq/Kg) |
|------------|----------------|---------------|-------------|-------------|---------------------|
| RRJESHTI 1 | 18.10.2017     | Ogliarola     | Olipe       | 0.3384      | 8                   |
| RRJESHTI 2 | 18.10.2017     | Nociara       | Kaolina     | 0.3384      | 8                   |
| RRJESHTI 3 | 18.10.2017     | Coratina      | Bio Botan   | 0.3948      | 6                   |
| RRJESHTI 4 | 18.10.2017     | Cima di melfi | Success 024 | 0.3948      | 6                   |
| RRJESHTI 5 | 18.10.2017     | Frantoio      | Kontroll    | 0.3384      | 9                   |



**Figura Nr. 7** Mini frantoio

## O. Boçova. Laboratori “Biokimik” QTTB - Vlorë, datë: 06.11.2017

Nga rezultatet e marra në analizë të dy elementet si; Aciditeti dhe Peroksidet kanë dalë në nivele shumë të ulta ndaj vlerave më të larta të lejuara ku Aciditeti lejohet deri në 1%, ndërsa Peroksidet deri në 20 mEq/kg. Si konkluzion rezulton se vaji i prodhuar hyn te treguesit e vajit të ullirit extra vergine.



**Grafikë 15;16.** Paraqitja grafike e Aciditetit dhe Peroksideve.

### 8. Konkluzione dhe rekomandime për të gjitha pikat e provave fushore, BEP Shamogjin - Vlorë.

- Produktet e zgjedhura për provat fushore janë produkte pa ndikime anësore në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis.
- Produktet më të mira nga ana ekonomike dhe lehtësia e përdorimit në nivel ferme janë Succses 024 dhe Eco trap. Për eko-trapet duhet shtuar sipërfaqia e provave për siguri izolimi nga parcelat fqinjë, si dhe duhen gjetur metoda për të vërtetuar freskinë e tyre, kohën e prodhimit dhe aftësinë tërheqëse dhe vrasëse të mizave.
- Këto dy produkte, pra Success 024 dhe Eko-trapet janë shumë të mirë ku dihet që janë zona me terrene të thyera e me pak fuqi punëtore dhe komoditeti që kanë këto dy produkte është zgjidhja e vetme për ullirin për momentin. Trajtimi i një hektari ullishte me këto dy produkte kryhet për një orë pune.

- Produktet Kaolinë dhe Bio Botan, u paraqitën kënaqshëm por, rezerva ndaj tyre qëndron në dozën e lartë të përdorimit (respektivisht 4 kg dhe 2 kg në 100 litra ujë), si dhe në sasinë e madhe të ujit që duan për përgatitjen e tretësirës spërkatëse. Këto dy produkte rekomandohen në ullishtet e mekanizuara dhe me burime uji afër.
- Produkti DAP me ujë, nuk duhet të përdoret si metodë e vetme, por vetëm si metodë shoqëruese, pra si masë plotësuese, që sidoqoftë për aq sa harxhohet për të ajo e justifikon veten me aq prodhim sa mbron, por nuk është metodë që të frenojë popullatën në kufij të pranueshëm të infeksionit.
- Nga të dhënat e marra gjatë këtij viti rezulton se infeksioni nga miza e ullirit ishte në nivele shumë të ulta. Kjo situatë ka ardhur si rezultat i temperaturave shumë të larta gjatë muajve Korrik dhe Gusht, ku u regjistruan shifra që variojnë nga 33 °C deri në 38 °C, e shoqëruar me një zgjatje kohore gjatë dy muajve.
- Këto përfundime anësore të studimit duhen pasur parasysh për prodhimin e ullirit në sezonin 2018. Nuk duhet nënvleftësuar mbrojtja nga sëmundja e syrit të palloit me preparate me bazë bakri dhe Sylit etj.,

**Drejtues Projekti:**

Mendim Baçaj  
Llambro Dhima

**Shef i financës:**

Luljeta Malaj

**TITULLARI:**  
**Dr. Aulona Veizi**